



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/ 2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Dt. 26.11.2019

Për: Operatori Ekonomik “BNT ELelectronics” sh.p.k me NIPT J61817047D.

Adresa: Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: Referuar Urdhërit të Prokurimit Nr.37 datë 11.09.2019 me objekt: **“Blerje pajisje it (kompjuter, printer, printer termik, printer matricor, fotokopje a4, barcode reader, palmar, tableta instanter)”** me fond limit 42.144.000 (dyzet e dy milion e njëqind e dyzet e katër mijë) Lekë pa T.V.SH., të vëna në dispozicion nga të ardhurat e Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., me procedurë “E hapur”, me mjete elektronike e cila u zhvillua më datë 14.10.2019, ora 10.00. *[Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor]*

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-35771-09-12-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje pajisje it (kompjuter, printer, printer termik, printer matricor, fotokopje a4, barcode reader, palmar, tableta instanter)”**

Fondi Limit: 42.144.000 (dyzet e dy milion e njëqind e dyzet e katër mijë) Lekë pa T.V.SH.

Burimi i financimit: Financuar nga të ardhurat e shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme;

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.10.2019, ora 10.00.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Datë 16.09.2019*
[37]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik “PC Store”** sh.p.k me NIPT L01606034A ka paraqitur ofertë ekonomike **38,242,000** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e dy mijë) lekë pa T.V.SH.
2. **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Atom” sh.p.k** me NIPT L22203042N dhe **“Kallfa” sh.p.k** me NIPT J71406006Q kanë paraqitur ofertë ekonomike **38,535,785** (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH.
3. **Operatori ekonomik “BNT Electronics ”** sh.p.k me NIPT J61817047D ka paraqitur ofertë ekonomike **40,933,886** (dyzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e tetë qind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa T.V.SH.

Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “PC Store” me NIPT L01606034A
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Atom” sh.p.k me NIPT L22203042N dhe “Kallfa” sh.p.k me NIPT J71406006Q

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. **Operatori ekonomik “PC Store”** sh.p.k me NIPT L01606034A ka paraqitur ofertë ekonomike **38,242,000** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e dy mijë) lekë pa T.V.SH.,

Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2.5 e cila citon: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për periudhën e garancisë për mallin që ofron, në të cilën të jenë përcaktuar qartë periudhat e garancisë sipas specifikimeve teknike.”* Operatori ekonomik PC-Store te deklarata e paraqitur ka specifikuar te artikull numër 2. Specifikisht Printer me garanci 1 vit. Në specifikime teknike artikulli numër 2 është Printer B&E A4 Standard me periudhë garancie prej 3 vitesh.

2. **Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2.3 (Për kapacitetin teknik) ku citohet:** *“2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi(distributori duhet të vërtetojë se është autorizuar nga prodhuesi)”*. Në këtë rast Operatori ekonomik ka paraqitur ndër të tjera autorizim nga Alba-Trade distributor i autorizuar për produktin HUAËEI por për të vërtetuar lidhjen e distributorit të autorizuar me prodhuesin është paraqitur ëëbsite i Alba-Trade i përkthyer dhe noterizuar jo dokumenti marrëveshje që vërteton se Alba-Trade është distributor i autorizuar nga prodhuesi.

3. **Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1.e** e cila citon: *“Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: e.Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”* Në këtë rast Operatori ekonomik PC-Store ka paraqitur vërtetim për detyrimet e shlyera nga OSHEE vetëm për kontratën me numër TR2A110005016334 përdorues i së cilës është PC-Store por nuk ka paraqitur të njëtin vërtetim dhe për kontratat e OSHEE të adresave të tjera që figurojnë në Ekstraktin Historik të QKB për PC-Store.

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Atom” sh.p.k me NIPT L22203042N dhe **“Kallfa” sh.p.k** me NIPT J71406006Q kanë paraqitur ofertë ekonomike **38,535,785** (tridhjetë e tetë milion e pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa T.V.SH.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 1.b e cila citon: “Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**b**).Deklaratë për paraqitje ofertë të pavarur sipas Shtojcës 2/1. Në këtë rast operatori ekonomik ATOM sh.p.k referuar shtojcës së paraqitur nuk ka plotësuar asnjë nga opsionet, gjërmën “a” ose “b” të pikës të deklaratës së sipër cituar.

Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2.3 (Për kapacitetin teknik) ku citohet: “2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi(distributori duhet të vërtetojë se është autorizuar nga prodhuesi)”.

a) Në këtë rast Operatori ekonomik ATOM sh.p.k se për zërin 6 “Tableta” janë marrë përsipër nga anëtari i BOE “Atom” sh.p.k., i cili në përmbushje të KVK ka dorëzuar autorizim distributor lëshuar nga “Globe Shops” sh.p.k., për pajisjet-tablet të markës Samsung. Gjithashtu është dorëzuar edhe marrëveshje Shitje dhe furnizimi e lidhur midis Samsung Elektronik Austria dhe Globe Shops rezulton se targat e dhëna nga kontrata e furnizimit nga Samsung Electronics lidhen me shitjen e produkteve të kësaj të fundit të konsumatorët fundor dhe jo palëve të treta siç është rasti i Shoqërisë Atom sh.p.k., e cila do ti shes palëve të treta në rastin konkret Posta Shqiptare sh.a. Nuk vërtetohet që Globe është distributori i Autorizuar nga Samsung.

b) Në lidhje me pajisjen HP, të cilat referuar kontratës së bashkëpunimit nr.1264 rep dhe nr.197/1 kol datë 12.10.2019 me anë të së cilës është krijuar edhe BOE “Atom” sh.p.k dhe “Kallfa” sh.p.k, rezultojnë se janë marrë përsipër nga anëtari i BOE “Atom” sh.p.k i cili ka paraqitur autorizimin e shoqërisë “Komtrejd Distribucia Dooel” lëshuar shoqërisë “Atom” sh.p.k. në të cilën deklarohet se shoqëria “Komtrejd Distribucia Dooel” shfaqet në cilësinë e distributorit të autorizuar të HP dhe jë pjesë e amendamentit të kontratës mes HP dhe CT Computers MK Dooel Skopje. Konstatohet se nuk është dorëzuar dokumentacioni që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar pasi dokumentacioni i dorëzuar është vetëm aneks kontrate dhe nuk është dorëzuar kontrata e plotë e lidhur mes HP dhe CT Computers MK Dooel Skopje.

3.Nga verifikimet e bëra në katalogun e dorëzuar të produktit Tablet rezulton se rezolucioni i kamerës është “Main Camera Resolution 8MP, CMOS dhe Front Camera Resolution 2 MP, CMOS” ndërkohë referuar specifikimeve teknike në dokumentat standarte të tenderit të produktit tablet, kërkohet që “Rear & Front Camera 8 MP”. Pra kërkohen të dy kamerat të jenë 8MP

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

Operatori Ekonomik **“BNT Electronics ”** sh.p.k me NIPT J61817047D me vlerë të ofertës **40,933,886** (dyzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e tetë qind e

tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa T.V.SH.. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a., Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kjo procedurë prokurimi anulohet pasi nuk ka operator ekonomik të klasifikuar vijues siç parashikohet në nenet 24 dhe 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.10.2019.

Ankesa: Ka patur.

Pranë Autoritetit Kontraktor janë paraqitur ankesat si më poshtë vijon:

Në datë 01.11.2019 është paraqitur ankesa nga operatori **“PC Store” shpk** me nr.2352/8 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 2352/13 prot. datë 07.11.2019.

Në datë 04.11.2019 është paraqitur ankesa nga **BOE “Atom” sh.p.k & “Kallfa” sh.p.k** me nr.2352/9 prot.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Posta Shqiptare sh.a., brenda afateve ligjore është trajtuar ankesa, Operatorit Ankimues i është kthyer përgjigje me nr. 2352/15 prot. datë 07.11.2019.

Në datë 04.11.2019 është paraqitur ankesa nga **“BNT Electronics” sh.p.k** me nr.2352/10 prot.

Pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ankimues **“BNT ELelectronics” sh.p.k.**, Datë 11.11.2019, ka vendosur të pranojë ankesën e operatorit ankimues **“BNT ELelectronics” sh.p.k** në lidhje me pretendimet e tij për rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori duke urdhëruar KVO-në të kualifikojë ofertë e ofertuar nga operatori **“BNT ELelectronics”**;

Për sa më sipër Komisioni i Vlersimit të Ofertave vendosi që të bëhet rivlerësimi i ofertave në zbatim të Relacionit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me Nr. 2352/16 prot., Datë 11.11.2019, me vlerë të ofertës 40,933,886 (dyzet milion e nëntëqindë e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtë) lekë pa t.v.sh. të miratuar nga Administratori i Shoqërisë.

Oferta e vetme e kualifikuar mbetet e Operatorit Ekonomik **“BNT ELelectronics” sh.p.k.**, me vlerë të ofertës 40,933,886 (dyzet milion e nëntëqindë e tridhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtë) lekë pa t.v.sh

Njoftimi i rivlerësimit është bërë në datë 15.11.2019 në zbatim të Relacionit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me Nr. 2352/16 prot., Datë 11.11.2019

Brenda afateve ligjore që nga rivlerësimi nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Laert Duraj